



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

SQARIM

Organi Qendror Blerës, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka publikuar procedurën e prokurimit me mjete elektronike, me REF-00400-12-19-2018 , “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4(katër) vite, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me fond të marrëveshjes kuadër në verën prej 744,358,551 (shtatëqind e dyzet e katër milion e treqind e pesëdhjetë e tetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Në zbatim pikës 1 të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar autoriteti kontraktor nisur nga rekomandimet e dërguara pas monitorimit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), ka hartuar këtë sqarim për dokumentet e tenderit si më poshtë:

I. Në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën 3.3/1, a) tek kriteret e veçanta të kualifikimit, Shtojca 8 e DT-së, ku është përcaktuar se:

1. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 30 % e vleres se fondit limit. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose/dhe faturat tatimore të shitjes,

Ju sqarojmë se, kriteri i mësipërm konsiderohet i plotësuar nga operatorët ekonomikë nëse në përmbushje të këtij kriteri operatorët ekonomikë paraqesin dokumentacion në një nga alternativat e mëposhtme:

*1- vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror
ose*

2- faturat tatimore të shitjes.

II. Në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën 3.3/2,a) tek kriteret e veçanta të kualifikimit, Shtojca 8 e DT-së, ku është përcaktuar se:

2. Operatori ekonomik duhet te provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit te ushqimit, për të cilin duhet te paraqesë:

a) Dokumentacion qe vërteton pronësinë, huapërdorjen ose marrjen me qira te këtij ambienti.

Ju sqarojmë se, kriteri i mësipërm konsiderohet i plotësuar nga operatorët ekonomikë nëse në përmbushje të këtij kriteri operatorët ekonomikë paraqesin dokumentacion në një nga alternativat e mëposhtme:

1- Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;

ose

- kontrata e shitblerjes;

ose

- kontrata e dhurimit;

ose

- çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

2- Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.

3- Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.